



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Programi: **Master Shkencor**

Drejtimi: **Histori**

**Lënda: DIASPORA SHQIPTARE**

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Fatmira Rama
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

**Përshkrimi:**

Programi synon të pajisë studentët me njohuri rreth diasporës shqiptare në shek.XIV - shek.XIX në prag të krijimit të shtetit shqiptar, nëntor 1912. Është disiplinë që ka për qëllim të informojë studentët për grupimet e diasporës shqiptare në Ballkan, Europë, SHBA, etj. Ai do t'i njohë studentët me tiparet e integritit të diasporës në vendet pritëse dhe me kontributet e gjithanshme të saj në këto vende si dhe në vendin amë.

**Temat e leksioneve:**

1. Emigracioni shqiptar në Greqi në shekujt XIV-XVIII. Shkaqet ekonomike, politike, fetare e sociale të emigracionit. Ngulimet e diasporës arvanitase dhe integrimi i saj në shoqëritë vendase. Trashëgimia e traditave kombëtare dhe kontributit tyre në zhvillimet kulturore në Greqi.
2. Roli i arvanitasve në Revolucionin Kombëtar grek dhe krijimin e shtetit të pavarur grek. Figura të shquara arvanitase në këtë lëvizje: Marko Boçari, Dhaskalina Bubulina, etj.
3. Emigracioni shqiptar në Italinë shek.XIV-XVII. Gjurmët e para dhe eksodimasiv pas vdekjes së Skënderbeut dhe okupimit osman të viseve shqiptare. Pritja e autoriteteve vendase dhe krijimi i lehtësive për akomodimin dhe integrimin e tyre në shoqëritë vendase.
4. Ngulimet arbëreshe dhe organizimi i tyre shoqëror dhe fetar në shek.XV-XVIII. Kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik dhe kulturor në vendin pritës dhe ruajtja e trashëgimisë së tyre kombëtare.
5. Kontributi i diasporës shqiptare në Itali në zhvillimet politike: arbëreshët dhe Garibaldi dhe figura të shquara në lëvizjen për krijimin e Italisë së bashkuar: XhuzepeKrispi etj.
6. Roli i arbëreshëve në Rilindjen Kombëtare Shqiptare përgjatë gjysmës së dytë shek. XVIII -shek.XIX dhe në fillimet e shek.XX. Kontributi i tyre në zhvillimin e kulturës shqiptare në gjuhën shqipe dhe në lëvizjen për liri e pavarësi. Figura të shquara të diasporës shqiptare në Itali dhe ndikimi i tyre në lëvizjen për autonomi dhe pavarësi nëShqipëri.
7. Diaspora e vjetër shqiptare në Rumani (shek. XVI-XVIII). Integrimi i saj në shoqërinë vendase dhe roli i saj në zhvillimet politiko-sociale dhe kulturore në Rumani
8. Roli i diasporës shqiptare në Rumani në lëvizjen kulturore në gjuhën shqipe dhe në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare përgjatë shek.XIX, fillimi i shek.XX. Shoqëritë kombëtare dhe kulturore, shtypi, figura të shquara. Dora D'Istria dhe roli i saj në kulturën shqiptare, ballkanike dhe europiane.

9. Diaspora shqiptare në Bullgari, ngulimet kryesore dhe roli i saj në zhvillimet shumëplanëshe në Bullgari dhe në lëvizjen kulturore dhe kombëtare në Shqipëri
10. Diaspora shqiptare në Turqi në shek. XVI – XIX dhe roli i saj në zhvillimet politiko-sociale në vend. Roli i Sami Frashërit, Hoxha Tahsinut etj., në zhvillimin e kulturës dhe të arsimit turk. Figura të diasporës shqiptare në administratën e lartë osmane, në art, culture etj.
11. Roli i diasporës shqiptare në Turqi për të drejtat kombëtare të shqiptarëve, për organizimin e tyre, për liri dhe pavarësi. Shoqëritë politiko-kulturore në gjysmën e dytë shek.XIX. Roli i Vëllezërve Frashëri etj., në lëvizjen kulturore në gjuhën shqipe dhe atë kombëtare.
12. Diaspora shqiptare në Serbi, Bosnjë, Kroaci, Hungari
13. Diaspora shqiptare në vendet europiane, në Ukrainë, Rusi etj.
14. Diaspora shqiptare e Egjiptit dhe roli i Mehmet Aliut në krijimin e shtetit modern shqiptar
15. Fillesat e emigracionit shqiptar në SHBA dhe Argjentinë në fund të shek.XIX, fillimi i shek.XX dhe veçoritë e tij. Veçoritë e para dhe kontributi i tyre në Shqipëri.

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në:70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II:në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursitose ese:rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

1. *Historia e popullit shqiptar*, Vëll.II, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.
2. *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, përmbledhjestudimesh, grupautorësh, Prishtinë, 1992.

#### **Literatura plotësuese:**

1. Aleksandër Xhuvani, *Shqiptari që krijoi Mbretërinë egjiptiane*, Tiranë: Toena 2003.
2. Antonio Belluchi, *Richerche e studitragliarbëroridell'Ellade*, Cozenze, 1994.
3. LuçiaNadin, *Shqiptarët nëVenetik, Mërgim e integrim*, 1479-1552, Tiranë, 2008
4. *La diaspora della diaspora*, Milano, 1989
5. KoliXoxe, *Shqiptarët e Garibaldit*, Tiranë, 2010
6. DhimitërGrillo, *Arvanitët dhe shqiptarët në luftën çlirimtare të popullit grek*, Tiranë, 2008
7. Valentina Duka, *Shqiptarët në rrjedhat e shek.XX*, Tiranë, 1998.
8. *ShënimeHistorike, 1893-1937*, Koloniashtqiptare e Sofjes, Sofje, 1937
9. CristiaMaksutoviç, *Un nume pe nedreptuitat: Dora D'Istria*, Bucuresti, 1995.

**MIRATOI**  
**Përgjegjësi i Departamentit**  
**Prof. asoc. EvaHyskaj**

*Tiranë, 2016*